VENDIM
Nr. 270, datë 10.12.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "*SUNNY SIDE ENERGY*" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2442/1 prot., datë 4.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë '*Sunny Side Energy*' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "*Sunny Side Energy*" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2442 prot., datë 25.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat: "a", "b" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a" dhe "c"; si dhe për pikën 2.1, germat: "a", "b", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "*Sunny Side Energy*" sh.p.k.:

- Ka depozituar vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 673, datë 30.10.2024, "Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë fotovoltaik dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesionit, në zonën kadastrale 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, qarku Fier, nga shoqëria '*Sunny Side Energy'* sh.p.k.";

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria "*Sunny Side Energy*", nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe shoqërisë "DESLA" sh.p.k.;

- Ka depozituar shkresën e shoqërisë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a., nr. 2152/3 prot., datë 26.4.2023, me anë të së cilës është miratuar në parim lidhja e parkut fotovolaik "*Sunny Side Solar"*, me rrjetin e transmetimit. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar për pikën e lidhjes.

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më 21.3.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "Ndërtimi i impiantit fotovoltaik '*Sunny Side Solar Park'*, me fuqi 100 mw". Kjo VNM është aktualisht e vlefshme (deri më 21.3.2026), por shoqëria duhet të bëjë me dije në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e centralit.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa "c": Shoqëria duhet të depozitojë strukturën organizative të saj në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa "b": Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës mbi aftësinë financiare për të realizuar investimin e plotë të veprës sipas vlerës së përcaktuar në kontratën me MIE-n dhe sipas mënyrës së financimit të parashikuar në planin e saj të biznesit.

- Po ashtu, shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse, në lidhje me jetëgjatësinë e centralit fotovoltaik dhe të depozitojë një dokument teknik në lidhje me jetëgjatësinë e tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "*Sunny Side Energy*" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "*Sunny Side Energy*" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti